

FAKULTETI I ADMINISTRIM BIZNESIT**RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT
MASTER PROFESIONAL NË ADMINISTRIM BIZNESI
I AVANCUAR, 120 ECTS****KREU I
PARIMET E PËRGJITHSHME****Neni 1
Baza ligjore**

Rregullorja e programit të studimit Master Profesional në Administrim Biznesi i Avancuar mbështetet në Ligjin nr. 80/2015 datë 22. 07. 2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Strategjinë e Zhvillimit të TBU-së, Statutin dhe Rregulloren për Programet e Studimit dhe Proçesin Mësimor.

**Neni 2
Objekti**

Kjo rregullore përcakton organizimin e programit të studimit Master Profesional në Administrim Biznesi i Avancuar për të tre Profilet, Menaxhim, Kontabilitet-Financë dhe E Drejtë Biznesi, duke respektuar legjislacionin në fuqi, lirinë akademike, të drejtat dhe detyrimet e personelit akademik dhe të studentëve.

Çdo aspekt tjetër që nuk është trajtuar në këtë rregullore do të trajtohet ashtu si përcaktohet në Rregulloren për Programet e Studimit dhe Proçesin Mësimor.

**KREU II
ELEMENTËT E PROGRAMIT MËSIMOR****Neni 3
Qëllimi dhe objektivat**

Qëllimi i këtij programi është të përgatisë adiminatorë profesionistë në fushën e menaxhimit, kontabilitet-financës dhe të drejtës së biznesit, të aftë të marrin përsipër menaxhimin dhe drejtimin në subjekte të ndryshme biznesi, por dhe në sektorë të tjerë, si sektori publik dhe sektori jofitimprurës.

Objektivat e programit janë:

- Të përgatisë studentët me njohuri teorike dhe praktike shumë të specializuara, në nivele të avancuara dhe bashkëkohore në fushën e administrimit të biznesit, të aftë të bëjnë analizë kritike të dijeve të mara.
- T’ju ofrojë studentëve njohuri të avancuara dhe bashkëkohore dhe t’ju mundësojë atyre aftësimin në profilet e menaxhimit, e kontabilitetit dhe atë të financave si edhe të drejtës së biznesit, të nevojshme për menaxhimin e shëndoshë të biznesit.
- Të përgatisë studentët me aftësi të specializuara për zgjidhjen e problemeve të ndryshme që hasen gjatë administrimit të një biznesi privat, apo në sektor publik dhe jo vetëm.
- Të kenë aftësi të zgjidhin probleme që kanë lidhje me kërkimin, zhvillimin apo inovacionin për të mbështetur operacionet e reja të biznesit, si edhe për të fituar pjesë të tregut.
- Të jenë kompetentë të kryejnë transformime thelbësore në pozicionet e punës ku punojnë, tju japin drejtim situatave të paparashikueshme duke gjetur zgjidhje strategjike për subjektet ku aktualisht kryejnë praktikën profesionale apo janë të punësuar.
- Objektivi kryesor i TBU është që studentët që ndjekin këtë program studimi të ngjiten një shkallë më lartë në karrierë përpara përfundimit të studimeve.

Neni 4

Programi i Studimit

- a) Programi i Studimit Master Profesional në Administrim Biznesi i Avancuar për të tre profilet është program i ciklit të dytë me kohëzgjatje normale 2 vite akademike dhe me 120 kredite (ECTS). Forma e studimit është me kohë të plotë.
- b) Programi mësimor është parashikuar të realizohet në 3,000 orë, nga të cilat 840 orë janë orë studimi në auditor dhe 2,160 janë orë studimi individual.
- c) Procesi mësimor është organizuar në 2 vite akademike, gjatë të cilit studenti fiton 120 kredite (ECTS). Viti akademik zgjat 30 javë mësimore dhe deri në 4 javë të parashikuara për sezonet normale të provimeve. Studenti kryen praktikë profesionale ose pune në profilin e tij të studimeve me jo më pak se 6 javë.
- d) Koha e struktura e fillimit, mbarimit, sezonet e provimeve, pushimet e festave zyrtare përcaktohen në kalendarin akademik të miratuar nga Senati Akademik në fillim të çdo viti akademik.

Neni 5

Struktura e programit mësimor

Studenti që ndjek këtë program studimi duhet të përfitojë të paktën 120 kredite, nga të cilat

6 ECTS në kategorinë e disiplinave të formimit të përgjithshëm (A); 42 ECTS në kategorinë e disiplinave karakterizuese (B); 36 ECTS në kategorinë e disiplinave ndërdisiplinore/integruese /profilizuese të programit (C); 12 ECTS në kategorinë e disiplinave plotësuese (D); 24 ECTS detyrime përmbyllesë (E).

Ky program studimi ka tre profile, Menaxhim, Kontabilitet – Financë dhe E Drejtë Biznesi. Në tabelat vijuese jepet struktura e veprimtarive formuese e secilit profil.

1. Profili Menaxhim

VEPRIMTARITË FORMUESE MASTER PROFESIONAL NË ADMINISTRIM BIZNESI I AVANCUAR, 120 ECTS, PROFILI MENAXHIM				
Kategoria	Tipi i komponentit mësimor		Lëndët	ECTS
A	Lëndë Bazë (5-10%) (6-12 ECTS)	1	Sjellje Organizative dhe Lidërsip	6
			Total ECTS	6
B*	Lëndët karakterizuese të Programit Master Profesional në AB (30-40%) (36 -48 ECTS)	1	Kontabilitet Menaxherial i Avancuar	6
		2	Drejtimit Financiar i Avancuar	6
		3	Menaxhim Projektsh	6
		4	Menaxhim Operacionesh	6
		5	Menaxhim Strategjik	6
		6	Administrimi i Bankave dhe Institucioneve Financiare	6
		7	Qeverisja e Korporatave	6
		8	Taksimi i Biznesit	6
		9	Vlerësim i Projekteve	6
		10	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore i Avancuar	6
		11	Menaxhimi i sistemeve të informacionit	6
			Total ECTS	42
C**	Lëndë Ndërdisciplinore/ Integruese/ Profilizuese, me zgjedhje (20-30%) (24 - 36 ECTS) Profili Menaxhim	1	Zhvillim Personal dhe Komunikim Ndërpersonal	6
		2	Një lëndë juridike nga: E drejtë Bankare dhe Financiare; E drejta Fiskale dhe e Krahasuar; E Drejtë Biznesi	6
		3	Biznesi Ndërkombëtar (LZ)	6
		4	Menaxhimi Strategjik i Marketingut (LZ)	6
		5	Menaxhimi i Mardhënieve me Klientët (LZ)	6
		6	Menaxhimi Strategjik i Markës (LZ)	6
		7	Menaxhimi i Cilësisë (LZ)	6

		8	Komunikimi në Biznes (LZ)	6
		9	Tregëtia Ndërkombetare dhe Menaxhimi I Zinxhirit të Shitjes (LZ)	6
		10	Marketingu Ndërkombëtar (LZ)	6
			Total ECTS	36
D	Lëndë Plotësuese (10%) (12 ECTS)	1	Praktikë Profesionale	12
			Total ECTS	12
E	Detyrime Përmbyllese (10-20%) (12 - 24 ECTS)	1	Raporti i Përvojës Profesionale/ Projekt Menaxhimi	10
		2	Temë Diplome /Provimi i Përgjithshëm Përfundimtar	14
			Total ECTS	24
Gjithsej 14 Lëndë		Profili Menaxhim		Total ECTS
120				
<p>* Lëndët e renditura ne këtë grup janë lëndë që karakterizojnë programet master në Administrim Biznesi. Nga të gjitha lëndët e renditura studentët do të bejnë 7 prej tyre, kjo në varësi edhe të lëndëve të zhvilluara prej tyre në studimet e mëparshme.</p>				
<p>** Dy lëndët e para të renditur në këtë grup janë lëndë ndërdisiplinore. Ndërsa lëndët e renditura si LZ janë lëndë që dallojnë profilin menaxhim, nga të cilat studenti do të zgjedhë vetëm 4 prej tyre.</p>				

2. Profili Kontabilitet-Financë

VEPRIMTARITË FORMUESE MASTER PROFESIONAL NË ADMINISTRIM BIZNESI I AVANCUAR, 120 ECTS				
PROFILI KONTABILITET - FINANCË				
Kategoria	Tipi i komponentit mësimor		Lëndët	ECTS
A	Lëndë Bazë (5-10%) (6-12 ECTS)	1	Sjellje Organizative dhe Lidership	6
			Total ECTS	6
B*	Lëndët karakterizuese të Programit Master Profesional në AB (30-40%) (36 -48 ECTS)	1	Kontabilitet Menaxherial i Avancuar	6
		2	Drejtimit Financiar i Avancuar	6
		3	Menaxhim Projektsh	6
		4	Menaxhim Operacionesh	6
		5	Menaxhim Strategjik	6
		6	Administrimi i Bankave dhe Institucioneve Financiare	6
		7	Qeverisja e Korporatave	6
		8	Taksimi i Biznesit	6
		9	Vleresim i Projekteve	6
		10	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore i Avancuar	6
		11	Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit	6
		Total ECTS	42	
C**	Lëndë Ndërdisciplinore/ Integruese/Profilizuese, me zgjedhje (20-30%) (24 - 36 ECTS) Profili Kontabilitet-Financë	1	Zhvillim Personal dhe Komunikim Ndërpersonal	6
		2	Një lëndë juridike nga: E Drejtë Biznesi, E Drejtë Falimentimi	6
		3	Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit	6
		4	Kontabilitet Financiar (LZ)	6
		5	Auditim i Avancuar (LZ)	6
		6	Menaxhim i Riskut Financiar (LZ)	6
		7	Kontabilitet Bankar (LZ)	6
		8	Tregje dhe Institucione Financiare (LZ)	6

		9	E Drejta Bankare dhe Financiare (LZ)	6
		10	Ekonomia Monetare (LZ)	6
		11	Analiza Financiare (LZ)	6
		12	E drejta Fiskale dhe e Krahasuar (LZ)	6
			Total ECTS	36
D	Lëndë plotësuese (10%) (12 ECTS)	1	Praktikë Profesionale	12
			Total ECTS	12
E	Detyrime Përmbyllëse (10-20%) (12 - 24 ECTS)	1	Raporti i Përvojës Profesionale/ Projekt Menaxhimi	10
		2	Temë Diplome /Provimi i Përgjithshëm Përfundimtar	14
			Total ECTS	24
Gjithsej 14 Lëndë		Profili Financë-Kontabilitet		Total ECTS
120				
<p>* Lëndët e renditura në këtë grup janë lëndë që karakterizojnë programet master në Administrim Biznesi. Nga të gjitha lëndët e renditura studentët do të bëjnë 7 prej tyre, kjo në varësi edhe të lëndëve të zhvilluara prej tyre në studimet e mëparshme.</p>				
<p>** Dy lëndët e para të renditura në këtë grup janë lëndë ndërdisiplinore. Ndërsa lëndët e renditura si LZ janë lëndë që dallojnë profilin Kontabilitet -Financë, nga ë cilat studenti do të zgjedhë vetëm 4 prej tyre.</p>				

3. Profili E Drejtë Biznesi

VEPRIMTARITË FORMUESE MASTER PROFESIONAL AB, PROFILI E DREJTË BIZNESI, 120 ECTS				
Kategoria	Tipi i komponentit mësimor		Lëndët	ECTS
A	Lëndë Bazë (5-10%) (6-12 ECTS)	1	Sjellje Organizative dhe Lidership	6
		Total ECTS		
B*	Lëndët karakterizuese të Programit Master Profesional në AB (30-40%) (36 -48 ECTS)	1	Kontabilitet Menaxherial i Avancuar	6
		2	Drejtim Financiar i Avancuar	6
		3	Menaxhim Projektsh	6
		4	Menaxhim Operacionesh	6
		5	Menaxhim Strategjik	6
		6	Administrimi i Bankave dhe Institucioneve Financiare	6
		7	Qeverisja e Korporatave	6
		8	Taksimi i Biznesit	6
		9	Vleresim i Projekteve	6
		10	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore i Avancuar	6
		11	Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit	6
Total ECTS			42	
C**	Lëndë Ndërdisciplinore/ Integruese/ Profilizuese, me zgjedhje (20-30%) (24 - 36 ECTS) Profili E Drejtë Biznesi	1	Zhvillim Personal dhe Komunikim Ndërpersonal	6
		2	Mjedisi Rregullator i Biznesit	6
		3	Marketing Ndërkombëtar	6
		4	Tregëtia Ndërkombetare dhe Menaxhimi I Zinxhirit të Shitjes	6
		5	E Drejtë Biznesi (LZ)	6
		6	E Drejtë Falimentimi (LZ)	6
		7	E Drejta Fiskale dhe e Krahasuar (LZ)	6
		8	E Drejta e Shoqerive Tregëtare (LZ)	6

		9	E Drejta e Konkurences dhe Antitrusti (LZ)	6
		10	E Drejta e Punës (LZ)	6
		11	E Drejta Europiane Private (LZ)	6
		12	E Drejta Bankare dhe Financiare (LZ)	6
		13	E Drejta Administrative e Avancuar dhe e Krahasuar 1 (LZ)	6
		14	Vleresim i Projekteve (LZ)	6
		15	E Drejta Civile dhe Kontratat (LZ)	6
			Total ECTS	36
D	Lëndë plotësuese (10%) (12 ECTS)	1	Praktikë Profesionale	12
			Total ECTS	12
E	Detyrime Përmbyllëse (10-20%) (12 - 24 ECTS)	1	Raporti i Përvojës Profesionale/ Projekt Menaxhimi	10
		2	Temë Diplome /Provimi i Përgjithshëm Përfundimtar	14
			Total ECTS	24
Gjithsej 14 Lëndë		Profili e Drejtë Biznesi		Total ECTS
120				
<p>* Lëndët e renditura ne këtë grup janë lëndë që karakterizojnë programet master në Administrim Biznesi. Nga të gjitha lëndët e renditura studentët do të bejnë 7 prej tyre, kjo në varësi edhe të lëndëve të zhvilluara prej tyre në studimet e mëparshme.</p>				
<p>** Dy lëndët e para të renditur në këtë grup janë lëndë ndërdisiplinore. Ndërsa lëndët e renditura si LZ janë lëndë që dallojnë profilin E Drejtë Biznesi, nga ë cilat studenti do të zgjedhë vetëm 5 prej tyre.</p>				

Neni 6

Lëndët dhe veprimtarite e tjera formuese

- a) Numri i veprimtarive formuese janë 14 lëndë ku janë parashikuar 14 provime, si edhe praktika profesionale, raporti i përvojës profesionale/ projekt menaxhimi gjithashtu edhe tema e diplomës/provimi i përgjithshëm përfundimtar.
- b) Lëndët janë ndarë në katër grupe kryesore: (A) lëndë bazë - 1 lëndë; (B) lëndë karakterizuese të programit - 7 lëndë; (C) lëndë ndërdisiplinore/integruese dhe të profilit - 6 lëndë; (D) praktika profesionale; (E) detyrime përmblyese, dhe dorëzimi dhe mbrojtja e Raportit të Përvojës profesionale/projekt menaxhimit dhe Temës së Diplomës/ Provimi i përgjithshëm përfundimtar.

Neni 7

Plani mësimor

Plani mësimor indikativ që pasqyron periudhën kohore të organizimit të secilës disipline dhe veprimtari formuese të programit, ngarkesën e tyre në ECTS, orë në auditor dhe orë pune individuale të ndara në semestra, është dhënë në Aneksin A për secilin profil të këtij programi studimi.

Neni 8

Fleksibiliteti i Strukturës dhe planeve mësimore

Planet mësimore të paraqitura në nenin 7 më sipër, mund të përshtaten çdo vit akademik në përputhje me propozimet e njësive bazë dhe aprovohen nga Rektori. Gjithashtu këto plane mësimore përshtaten edhe në përputhje me nenet 6,7, 12 dhe 32 të Rregullores për Programet e Studimit dhe Procesin Mësimor.

Neni 9

Praktikat mësimore

Organizimi dhe zhvillimi i trajnimit praktik bëhet sipas procedurave të përcaktuara në Rregulloren për Programet Studimit dhe Procesit Mësimor dhe Rregulloren për Praktikën Mësimore.

Neni 10

Kontrolli i dijes dhe sistemi i vlerësimit

Rregullat për zhvillimin e procesit mësimor, kontrollin e dijes dhe sistemin e vlerësimit janë të përcaktuara me detaje në nenet 14-23 të Rregullores për Programet e Studimit dhe Procesin Mësimor.

KREU III

PRANIMI I STUDENTËVE DHE AFATET E STUDIMIT

Neni 11

Kriteret dhe Procedura e Pranimit të Studentëve

- a) Programi i studimeve të ciklit të dytë Master Profesional në Administrim Biznes i Avancuar, është program i hapur për të gjithë ata studentë që zotërojnë diplomë Bachelor të shoqëruar me suplementin e diplomës, shqiptare ose të huaj, sipas standardit dhe rregullave të vendosura nga MASR, si dhe për studentët me transferim.
- b) Përpara fillimit të rregjistrimeve të çdo viti akademik Njesitë Bazë përgjegjëse për Programin e Studimit përcaktojnë edhe kritere të veçanta të cilat miratohen nga Rektori i TBU.

Neni 12

Afati i studimeve

- a) Kohëzgjatja normale e studimeve në programin e studimit Master Profesional në Administrim Biznesi i Avancuar është 2 vite akademike.
- b) Në çdo rast studenti nuk mund të zgjasë studimet përtej dyfishit të afatit zyrtar të programit të studimit përveç rasteve kur ai ka pezulluar studimet ashtu si përcaktohet në Rregulloren për Programet Studimit dhe Procesit Mësimor.

KREU IV

VLERËSIMI ME KREDITE

Neni 13

Kreditet dhe llogaritja e tij

Kreditet për çdo modul përcaktojnë ngarkesën në orë mësimore në auditor si dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara nga programi. Në tabelën më poshtë është dhënë ndarja në orë në auditor dhe orë pune individuale, që është përdorur si rregull për cdo një kredit për këtë program studimi.

1 kredit (ECTS) = 25 orë punë në total
Orë në auditor = rreth 10 orë
Orë punë individuale = rreth 15 orë
(Detyra shtëpie, Punë në grup, Provime të pjesshëm, Provimi final)

KREU V

VLERËSIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT

Neni 14

Sigurimi dhe vlerësimi i cilësisë

- a) Rezultatet dhe niveli cilësor i aktiviteteve formuese të zhvilluara në programin e studimit të ciklit të dytë “Master Profesional në Administrim Biznes i Avancuar” vlerësohen çdo vit në përfundim të programit, sipas modaliteteve që do të përcaktojnë Njesia e sigurimit të brendshëm të cilësisë.
- b) Vlerësimi shërben si bazë për vazhdimësinë e programit të studimit dhe përmirësimin e tij në vite.
- c) Grupi i vlerësimit të brendshëm në bashkëpunim me Njesinë e sigurimit të brendshëm të cilësisë mbledh të gjithë informacionin për përgatitjen e raportit të vlerësimit të brendshëm.

KREU VI DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 15

- a) Kjo rregullore mund të përsoset e korrigohet në përputhje me zhvillimet dhe detyrat e reja që merr përsipër programi Master Profesional në Administrim Biznes i Avancuar.
- b) Të drejtën e interpretimit të kësaj Rregulloreje e ka Dekani i Fakultetit Administrim Biznesi dhe Rektori.

ANEKSI A
Plani Mësimor i Programit Master Profesional në Administrim Biznesi i Avancuar, Profili Menaxhim, Kontabilitet Finance dhe E Drejte Biznesi

PLANI MËSIMOR I PROGRAMIT MASTER PROFESIONAL NË ADMINISTRIM BIZNESI I AVANCUAR , 120 ECTS, TRE PROFILET											
SEMESTRI	Nr.	Lëndët	Kategoria e vep.formuese	ECTS	Leksione	Seminare	Javë gjithsej	Gjithsej Leksione	Gjithsej Seminare	Total orë në auditor	Orë pune individuale
SEMESTRI I	1	Lëndë karakterizuese e programit AB*	B	6	2	2	15	30	30	60	90
	2	Lëndë karakterizuese e programit AB	B	6	2	2	15	30	30	60	90
	3	Lëndë karakterizuese e programit AB	B	6	2	2	15	30	30	60	90
	4	Lëndë karakterizuese e programit AB	B	6	2	2	15	30	30	60	90
Total semestri I*				24	8	8	15	120	120	240	360
SEMESTRI II	5	Lëndë karakterizuese e programit AB	B	6	2	2	15	30	30	60	90
	6	Sjellje Organizative dhe Lidërsip	A	6	2	2	15	30	30	60	90
	7	Lëndë karakterizuese e programit AB	B	6	2	2	15	30	30	60	90
	8	Lëndë karakterizuese e programit AB	B	6	2	2	15	30	30	60	90
Total Semestri II*				24	6	6	15	90	90	240	360
Total Viti I				48			30	210	210	480	720
SEMESTRI III	1	Zhvillim Personal dhe Komunikim Ndërpersonal	C	6	2	2	15	30	30	60	90
	2	Lënda e dytë ndërdisiplinore	C	6	2	2	15	30	30	60	90
	Lëndë me Zgjedhje**										
	3	Lëndë me Zgjedhje nr.1	C	6	2	2	15	30	30	60	90
4	Lëndë me Zgjedhje nr.2	C	6	2	2	15	30	30	60	90	
Total semestri III				24	6	6	15	90	90	240	360
SEMESTRI IV	Lende me Zgjedhje**										
	5	Lëndë me Zgjedhje nr.3	C	6	2	2	15	30	30	60	90
	6	Lëndë me Zgjedhje nr.4	C	6	2	2	15	30	30	60	90

Praktikë Profesionale	D	12							300
Raporti i Përvojës Profesionale/ Projekt Menaxhimi	E	10							250
Temë Diplome /Provimi i Përgjithshëm Përfundimtar	E	14							350
Total semestri IV		48	4	4	15	60	60	120	1080
Total Viti II		72			30	150	150	360	1440
TOTAL Programi Master AB i Avancuar		120			60	360	360	840	2160

* Lëndët e renditura me këtë emërtim do të jenë nga grupi i lëndëve karakterizuese të programit AB të paraqitur në strukturën e elementëve mësimore të këtij programi. Gjithsej do të zhvillohen 7 lëndë, kjo në varësi edhe të lëndëve të zhvilluara prej tyre në studimet e mëparshme.

** Nga ky grup studenti do të zgjedhë vetëm 4 lëndë, të cilat janë lëndë që dallojnë profilin specifik. Grupi i lëndëve me zgjedhje për secilin profil jepen në strukturën e veprimtarive formuese të secilit profil.